



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 2010/2
Prishtinë, më 26. 01. 2010, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Të ftuar: Kryetari i Këshillit Koordinues i Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve.

Pjesëmarrës të tjerë: Rrezarta Ahmeti – KDI, Ajkuna Tolaj - Radio Kosova, Elita Vokshi dhe Lejla Selimi – OSBE.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi Ismet Beqiri. Konstatoi se ishin plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e mbledhjes.

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

- 1 Miratimi i rendit të ditës,
- 2 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19. 01. 2010,
- 3 Takimi me kryetarin e Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve,
- 4 Informim lidhur me numrin e vendimeve të KPMK-së, të paekzekutuara,
- 5 Shqyrtimi i petitionit të një grupi të qytetareve nga KK i Dragashit,

6 . Të ndryshme

1 Miratimi i rendit të ditës

Drejtuesi - I propozoi Komisionit që si pikë e rendit të hynte miratimi i planit të punës të Komisionit për gjashtëmujorin e parë. Arsyetimin e mbështeti në përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 03-P-177/k, të datës 19. 01. 2010, me të cilin obligohen komisionet parlamentare që deri më 29 janar 2010 ta miratojnë Planin e punës.

Komisioni e miratoi rendin e ditës me shtimin e pikës: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Komisionit për vitin 2010.

2 . Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19. 01. 2010

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 19. 01. 2010.

3 . Takimi me kryetarin e Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve

Ismet Beqiri – E falendori Haki Kosumin për punën e palodhshme dhe shtoi se fati i të pagjeturve mbetet shumë shqetësues deri në zbardhjen e tyre. Ai tha sikurse deri me tani, edhe në të ardhmen, Komisioni do të angazhohet për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, duke e sensibilizuar këtë çështje në të gjitha nivelet.

Haki Kasumi – Kryetar KKAFFZHK-së e paraqiti para Komisionit Projektin e Asociacionit, i cili e ka për qëllim ndërgjegjësimin e familjeve për ta dhënë pëlqimin për zhvarrosjen e trupave të të afërmeve të tyre, që ishin viktimë të luftës në Kosovë, si dhe për t'i dhënë mostrat e gjakut për ta mundësuar zbatimin e metodës së ADN. Shtoi se tash e 10 vjet ushtrime aktivitet në baza vullnetare dhe se numri i të zhdukurve është 1875. Aty përfshihen të gjitha nacionalitetet. U tha se Asociacioni ka shprehur gatishmërinë ta bëjmë një projekt të përbashkët me ndihmën e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Pagjetur. Ta formojmë një nënkëshill me komunitetin serb për bashkëpunim, për të cilin jemi shumë të interesuar. Kemi kërkuar nga kryetari i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur ta marrë përsipër organizimin e disa aktiviteteve, siç janë: shënimi i 27 prillit - Dita e të pagjeturve të Kosovës, 30 gushti - Dita ndërkombëtare për të pagjeturit.

Në fund Komisioni e mbështeti projektin, por realizimi i tij kërkon kosto të konsiderueshme të mjeteve, prandaj lidhur me këtë Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni I rekomandon Zyrës së Kryeministrit për personat e pagjetur dhe Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale që të ndihmohet Këshillit Koordinues i Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve në ushtrimin e veprimtarisë së rregullt ,që deri me tani ka dëshmuar si bartës kryesor I procesit të hulumtimit dhe gjetjes se personave të zhdukur ne Kosovë

4 . Informim lidhur me numrin e vendimeve të KPMK-së, të paekzekutuara

Kryetari - Propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës. Arsyetimin e mbështeti se anëtarët nuk janë të njoftuar me përmbajtjen e materialit, i cili ishte voluminoz.

Drita Maliqi – Ishte e mendimit që kjo çështje të shqyrtohet dhe të debatohet në një seancë të veçantë në Kuvend. Kërkoj nga Komisioni që çështja të mos zvarritet.

Të gjithë u pajtuan që për këtë çështje të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit një seancë e veçantë.

4 . Shqyrtimi i peticionit të një grupi të qytetarëve nga KK i Dragshit

Nerxhivane Dauti - E njoftoi Komisionin me përmbajtjen e peticionit dhe tha se 15 nënshkruesit e fshatit Orqushë e kundërshtojnë vërejtjen e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Nënshkruesit e peticionit theksojnë se kanë fakte të mjaftueshme të argumentojnë se nuk i kanë borxh KEKU-të, por fjala është për faturat e RTK-së, të cilat nuk janë paguar ka që 6 vjet dhe tani po u ngarkohen në emër të rrymës së harxhuar.

Në lidhje me këtë Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni u rekomandon nënshkrueseve të peticionit t'i drejtohen Zyrës së Rregullatorit për Energji Elektrike të KEKU-t dhe pasi të shteren procedurat ligjore të kërkojnë mbrojtje me padi në gjykatën kompetente.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës të Komisionit për vitin 2010

Pas një debati të gjerë dhe konstruktiv të zhvilluar për planin e punës dhe të prezantimit të znj. Elita Vokshi - OSBE, Komisioni e miratoi Planin e Punës për gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri